

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar, Vahid Halili dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit S.R., për shkak të katër veprave penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë, ankesës së mbrojtësit të akuzuarit av.Sh.P., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.362/2014, të dt.19.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur në kuptim të nenit 390 të KPRK, me dt.31.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë, NDRYSHOHET pjesa gjyquese e aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.362/2014, i dt.19.12.2016, vetëm sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit S.R., për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK, më hollësisht të përshkruar në dispozitivin nën II të aktgjyqimit i përcakton dënimin me gjobë në shumë prej 6,000.00(gjashtëmijë)Euro, ndërsa për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK, më hollësisht të përshkruar në dispozitivin nën III të aktgjyqimit i përcakton dënimin me gjobë në shumë prej 2.000(dymijë)Euro dhe konformë nenit 80 par.1 dhe 2 nën par.2.4 të KPRK e gjykon me dënim unik me gjobë në shumë prej 8.000(tetëmijë)Euro, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt. 11.07.2012 deri me dt.11.08.2012, duke ia llogaritur një ditë paraburgim me 20Euro.

II.Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa prekur.

III.REFUZHET e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë në pjesën liruese të aktgjyqimit si dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.R..

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.362/2014, i dt.19.12.2016, i akuzuari S.R., është shpallur fajtor për dy vepra penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK dhe për veprën penale të dispozitivin nën II të aktgjykimit i është përcaktuar dënimi me gjobë në shumë prej 4.000(katërmijë)Euro dhe për veprën penale ushtrimi i ndikimit të dispozitivit nën III të aktgjykimit i është përcaktuar dënimi me gjobë në shumë prej 1.000(njëmijë)Euro dhe për këto dy vepra është gjykuar me dënim unik me gjobë në shumë prej 5.000(pesëmijë)Euro, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.11.07.2012 deri me dt.11.08.2012, të cilin dënim i pandehuri është detyrua që të paguajë në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk paguan gjobën, gjykata do të ia zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që çdo 20Euro të filluara do ti zëvendësohen me një ditë burgim.

Është detyruar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100Euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarit A.P., L.A. dhe S. P., për realizmin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil, ndërsa i dëmtuari R.R., nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Ndaj të akuzuarit S.R., në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK, është refuzuar akuza për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-dispozitivi nën I i aktgjykimit, ndërsa i akuzuari S.R., për veprën penale ushtrimi i ndikimit në dispozitivin nën IV të aktgjykimit është liruar nga akuza.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ankesë ka paraqitur:

-Prokuroria Themelore-DKR në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkëljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet për veprën penale të dispozitivit nën IV, për të cilën vepër penale i akuzuari

është liruar nga akuza, duke propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim meritor, ndërsa të akuzuarit në vend të dënimit me gjobë ti shqiptohet dënim me burgim për veprat penale në pikat II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit.

-Mbrojtësi i të akuzuarit S.R., av.Sh.P.j, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe për veprat penale në pikën II dhe III të aktgjykimit të ankimuar të refuzohet akuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.103/2017, të dt.03.03.2016, ka propozuar që ankesa e PTH-DKR të aprovohet si e bazuar, ashtu që pjesën dënuese të aktgjykimit ta ndryshoj vetëm sa i përket vendimit për dënim si sanksion penal dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim, ndërsa për pjesën liruese aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim, ndërsa të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit.

Gjykata në kuptim të nenit 390 të KPPK, mbajti seancën e kolegjit për të cilën nuk është njoftuar Prokurori i Apelit, të dëmtuarit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, meqenëse të akuzuarit nuk iu është shqiptuar dënim me burgim.

Gjykata shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesat e Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë dhe mbrojtësit të akuzuarit dhe gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë, sa i përket pjesës gjyqësore të aktgjykimit është e bazuar, ndërsa sa i përket pjesë liruese të aktgjykimit është e pabazuar, e gjithashtu edhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit është e pabazuar.

Gjykata duke shqyrtuar aktgjykimin sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 par.1 të KPPK, gjen se aktgjykimi nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari ka qenë prezent, gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari ka pasur mbrojtës dhe se nuk është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.

Pretendimet për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria konsideron se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike kur të akuzuarin S.R. e ka liruar nga akuza me arsyetim se nuk është provuar se i pandehuri ka kryer veprën penale në pikën IV të dispozitivit të aktgjyqimit.

Gjykata e shkallës së parë, nuk ka marrë për bazë deklaratën e dëshmitares L.A., të dhënë në polici e cila bindshëm ka përshtetur veprimet e të akuzuarit, që deklarata e dëshmitares L.A., ka mbështetje në pasqyrën bankare të dëshmitares L.A., nga Procredit Bank, të cilën e ka cekur edhe gjykata në aktgjykimin e saj dhe këtë gjykata nuk e ka marrë për bazë dhe nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, me çka është argumentuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar si në pikën IV të dispozitivit të aktgjyqimit, andaj konsideron se gjykata nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike edhe pse në aktgjykim ceket dëshmia e dëshmitares L.A..

Gjykata duke vepruar në mënyrë jo të drejtë dhe duke vlerësuar në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, ka liruar S.R., për veprën penale të cekur më lartë edhe pse në veprime të akuzuarit kanë ekzistuar elemente të veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK.

Pretendimet e prokurorisë se në aktgjykimin e ankimuar sa i përket pikës IV të dispozitivit të aktgjyqimit gjendja faktike nuk është vërtetuar e drejtë ajo çka është vërtetuar është e gabuar, janë pretendime të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë, ka administruar provat e propozuara duke dëgjuar edhe dëshmitaren L.A.n dhe pas vlerësimit të provave të administruara ka gjetur se nuk është provuar se i akuzuari S.R., me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm duke shfrytëzuar pozitën e tij, për të ushtruar ndikim të pa duhur në vendimmarrje te personat zyrtar-profesorët e lëndës së kimisë analitike dhe kimisë inorganike, për dhënien e këtyre provimeve, për arritjen e kushtit për vitin e dytë në Fakultetin e Mjekësisë në nëntor të vitit 2011, ka kërkuar shumën prej 2.500Euor, të cilën shumë në Prishtinë, në veturën e tij afër postës kryesore ia ka dhënë dëshmitarja L.A., ku me këtë rast ka qenë edhe e dëmtuara.

Dëshmitarja L.A., në shqyrtimin gjyqësor me dt.24.05.2016, ka theksuar se ka dhënë deklaratë në polici, por nuk i kujtohet a e ka nënshkruar të njëjtën. Se e njeh personin S.R., e njeh S.n, të cilën e ka shoqe, shkollën e mesme e ka kryer në Gjilan, drejtimi i farmacisë. Pas shkollës së mesme është regjistruar në fakultet. Se të akuzuarin S.R., e ka pasur kujdestar të klasës në dy vitet e shkollës së mesme në Gjilan. E njeh Qëndresën, e cila është fëmijë e

Sd.ut, të cilën e ka pasur në klasë. Është takuar me Sd., arsyeja e takimit ka qenë që pasi që S., Q., kanë banuar së bashku ka rastisur që të takoheshin si kjo me prindërit e Q. ashtu edhe ajo me të L.. E dinë se i akuzuari Sd., ka punuar në spital. Ka mundësi që të kenë shkuar me Qëndresën në zyrën e të akuzuarit Sd., por nuk është e sigurt. Në fakultetin e mjekësisë, ka përfunduar vitin e parë dhe kushtin e ka mbërri me kohë.

Dëshmitares i është parashtruar pyetja se a ka kontaktuar me Sd. lidhur me arritjen e kushtit nga dëshmitarja konkretisht për shumën e parave prej 1.800Euro, dëshmitarja është përgjigjur se ka biseduar, por jo për dhënien e parave, konkretisht e ka pyetur se a ka mundësi me i ndihmuar apo si me ia bë. I akuzuari është përgjigjur se është vonë dhe nuk mundemi me bë asgjë. Për vitin e dytë kushtin nuk e ka mbërri nëse nuk gabon për lëndën kimi analitike dhe nuk i kujtohet për ndonjë lëndë tjetër. Nuk i kujtohet a ka komunikuar me telefon me të akuzuarin S.R.. Pasi dëshmitarja është ballafaquar me deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar se nuk i kujtohet nëse ka deklaruar ashtu, por për këtë punë nuk ka dhënë para.

Si ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, dëshmitarja L.A., ka dhënë disa detaje në lidhje me pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, por gjykata konstaton se nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar faktin vendimtar dhe se nuk ka mbështetje në prova tjera dhe në mungesë të provave të akuzuarin e ka liruar nga akuza.

Këtë konstatim të gjykatës së shkallës së parë e aprovon edhe kjo gjykatë sepse me provat e administruara nuk vërtetohet fakti se i akuzuari ka kryer veprën penale në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, e sidomos duke pasur parasysh deklaratën e dëshmitares L.A., të dhënë në shqyrtim gjyqësor, e cila deklaron se me të akuzuarin Sd., ka biseduar, por jo për dhënien e parave, por vetëm e ka pyetur të akuzuarin a ka mundësi për ti ndihmuar, e duke pasur parasysh se si konstaton edhe gjykata e shkallës së parë, gjykata vendimin e bazon në prova të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, meqenëse faktet vendimtare nuk janë vërtetuar e duke u nisur edhe nga parimi "in dubio pro reo", i paraparë në nenin 3 par.2 të KPPK, se gjykata është e detyruar që mëdyshjet për ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij, atëherë edhe kjo gjykatë si gjykata e shkallës së parë, gjen se nuk është provuar se i akuzuari S.R., ka ndërmarrë veprimet për të cilat është akuzuar.

Pretendimet për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria konsideron se gjykata me rastin e aktgjykimit lirues për të akuzuarin S.R., e ka liruar nga akuza për veprën penale në dispozitivin nën IV të aktgjykimit, gjykata ka bërë shkelje të ligjit penal.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.R., av.Sh.P., konsideron se në rastin konkret dënimi i shqiptuar nuk është në harmoni me dispozitat ligjore për faktin se kur shqiptohet dënimi unik i njëjti duhet të jetë më i ulët se sa që është shqiptuar.

Në gjykatën e shkallës së parë, mbrojtja vazhdimisht ka potencuar se kemi të bëjmë me arritjen e parashkrimit absolut dhe çdo aktivitet procedural duhet të ndërprehet, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe e njëjta ka vazhduar procedimin e çështjes.

Në dispozitiv të aktgjykimit nën II, thuhet se i akuzuari është fajtor sepse në periudhën kohore gjatë muajit gusht dhe shtator të vitit 2011, ka kryer veprime inkriminuese të përshkruara më gjerësisht në këtë dispozitiv.

Njëherit në dispozitivin nën III, të aktgjykimit thuhet se në nëntor të vitit 2011 ka kryer veprim inkriminues të përshkruar më gjerësisht në këtë dispozitiv.

Vepra penale ushtrimi i ndikimit të paraparë në neni 345 par.1 të KPK, thuhet kushdo që kërkon, merr, ose pranon ..., nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vite.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me institutin e parashkrimit, pra në rastin konkret ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Pretendimet e prokurorisë dhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur ligji penal, janë të pabazuara.

Si janë dhënë gjetjet e kësaj gjykate te pretendimet e prokurorisë për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kjo gjykatë ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka gjetë se nuk është provuar se i akuzuari S.R., ka kryer veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK, prandaj, gjykata e shkallës së parë, drejt ka zbatuar ligjin penal kur të akuzuarin S.R., e ka liruar nga akuza për këtë vepër penale.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur ligji penal kur të akuzuarit i është shqiptuar dënim unik si në dispozitiv të aktgjykimit, e i njëjti do të jetë më i ulët sesa i janë shqiptuar, është i pabazuar.

Sipas nenit 80 par.1 dhe 2 nën par.2 pika 4 të KPRK, nëse gjykata ka shqiptuar dënimin me gjobë për secilin nga veprat penale, dënimi unik me gjobë është shuma e dënimeve të shqiptuara, por nuk mund të tejkaloj shumën prej 25.000Euro, pra, në rastin konkret të akuzuarit dënimi unik i është shqiptuar në harmoni me dispozitën e nenit të cituar më lartë, prandaj, pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit është i pabazuar.

Pretendimi tjetër i mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit meqenëse është bërë parashkrimi absolut i ndjekjes për veprat penale për të cilat është akuzuar i akuzuari, është i pabazuar.

I akuzuari S.R., është shpallur fajtor se veprën penale në dispozitivin nën II të aktgjyqimit të ankimuar e ka kryer gjatë muajit gusht dhe shtator të vitit 2011, ndërsa veprën penale në dispozitivin nën III të aktgjyqimit të ankimuar e ka kryer në muajin nëntor të vitit 2011.

Sipas nenit 90 par.1 nën par.5 të KPPK (nenit 106 par.1 nën par.1.5 të KPRK), ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tri vite nga kryerja e veprave penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim.

I akuzuari S.R., është shpallur fajtor për veprën penale ushtrim i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK, për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në dy vite.

Për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor i akuzuari S.R.-veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK, parashkrimi absolut arrinë kur të kalojnë gjashtë vite nga kryerja e veprave penale ushtrimi i ndikimi, meqenëse vepra penale në dispozitivin nën II, është kryer në muajin gusht dhe shtator të vitit 2011, ndërsa vepra penale në dispozitivin nën III, është kryer në fund të muajit nëntor të vitit 2011, akoma nuk ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale sepse akoma nuk kanë kaluar gjashtë vite nga kryerja e veprës penale (e as ai relativ meqenëse organet kompetente kanë ndërmarrë veprime në drejtim të ndjekjes penale, të të akuzuarit), prandaj, pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit është i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, drejt ka zbatuar ligjin penal kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit S.R., ekzistojnë elementet e veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK, për të cilat vepra penale edhe e ka shpallur fajtor të akuzuarin, pasi që më parë ka gjetur se penalisht është përgjegjës.

Pretendimet për shkak të vendimit për dënim dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria konsideron se dënimi unik me gjobë i shqiptuar të akuzuarit S.R., në rastin konkret nuk është adekuat me peshën e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit. Konsideron se me një dënim të atillë të shqiptuar nuk do të arrihet qëllimi i dënimit.

Pretendimi i prokurorisë se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i butë, është i bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit të akuzuarit i ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar, është familjar, babë i fëmijëve, ndërsa rrethana posaçërisht rënduese nuk ka gjetur.

Rrethanat lehtësuese që i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë, i aprovon edhe kjo gjykatë, por gjykata e shkallës së parë, nuk ka marrë parasysh rrethanën rënduese se i akuzuari me profesion është mjek, se përveç profesionit të mjekut ushtronte edhe profesionin e mësimit, se të ardhurat që kishte i ofronin një jetë të denjitetshme, se i njëjti me veprimet e tij ka ndikuar që personi i interesuar pa merit t'ia zë vendin personit që ka merituar të regjistrohet në fakultetin e mjekësisë apo dhënien e provimit pa meritë, se i akuzuari si person me arsimim të lartë kupton shumë mirë vlerat shoqërore, prandaj, prokuroria me të drejtë pretendon se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nuk është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, për ç arsye edhe vendimi mbi dënim u ndryshua dhe të akuzuarit S.R., iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me bindje se vetëm me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit S.R., në tersi do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenit 41 të KPRK, e që është të parandaloj të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitim e tij, të ndaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale dhe të ndikoj në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 401 dhe 403 par.1 nën par.1.2 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.95/2017, të datës 31.03.2017

Procesmbajtësi,

Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit:

1.Vahid Halili

2.Mejreme Memaj

Kryetari i Kolegjit,

Xhevdet Abazi
